



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 18-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 30. 04. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Egzona Bytyqi, anëtare
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Afrim Miftari, anëtar
21. Hajdin Bytyqi, anëtar
22. Safete Amerllahu, anëtare
23. Bashkim Budakova, anëtar
24. Ukë Kryeziu, anëtar
25. Ganimete Qeriqi, anëtare
26. Manush Shamolli, anëtar
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Arben Salihu, anëtar
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete
4. Avni Olluri, drejtor i DA

5. Rasim Hasani, drejtor i DKA
6. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
7. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
8. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
9. Imer Rustemi, drejtor i DI,
10. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
11. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
12. Vlora Krasniqi, zyrtare ligjore
12. Besart Troshupa, zyra e informimit
13. Haki Avdiu,
14. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHR"
15. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Rrahim Krasniqi**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 29 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 17-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2019
3. Propozim Rregullorë për transportin e udhëtarëve me automjete Taksi
4. Propozim Vendim për shfuqizimin e pjesërisht të vendimit 15Nr.464-40375 të dt.29.09.2014 dhe shfuqizimin e tërësishëm të vendimit 15Nr.464-61538 dt. 21.12.2015.
5. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për të pame në fshatin Ribar i Madh.
6. Propozim Vendim për dhënien e pelqimit për ndarjen e mjeteve financiare shoqatës sindikale të administratës komunale, Nr. 1-400-26014 i datës 15. 04. 2019.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, përshëndeti të pranishmit dhe fillimisht i njoftoi lidhur me zëvendësimin e dy anëtarëve të ri nga radhët e LDK-së. Tha se në vend të Diamant Bytyqit është anëtar i ri Arif Miftari dhe në vend të Linda Shahinit është Fatime Krasniqi. Dhe i ftoj të japin betimin anëtarët e ri.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës.

Nazmi Krasniqi, tha se edhe në seancat e kaluara kemi kërkuar që si pike e rendit të ditës të jetë raporti për arsimin. Nuk e dijë pse vazhdimisht po i iket kësaj pike kur dihet se gjendja në arsim nuk është e mirë dhe ka shumë çështje për t'u debatuar.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, edhe në seancën e kaluar e keni ngritë këtë çështje, por për shkak të grevës kjo pikë e rendit të ditës është shtyer, në njëren nga seancat e radhëshme do ta kemi këtë pikë të rendit të ditës pasi që kam biseduar edhe me drejtorin e arsimit. Pastaj i njoftoi të pranishmit se kemi dy anëtarë të ri që do ta japin benimin.

Meqë vërejtje nuk pati rreth rendit të ditës, Kryesuesi vuri në votim dhe pas votimit me të gjitha votat prezente kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ganimete Qeriqi, para dy seancave kam pasur me ngritë një çështje por meqë nuk ishte Kryetari nuk i kam ngritur, po e shoh që edhe sot po mungon Kryetari atëherë po i drejtohem Nënkryetarit. Drejtorit të kulturës ju pata drejtua me një kërkesë ai më është përgjigjur pozitivisht. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport paska marrë nën mbrojtje objektin e radios Kosova e lirë në Krojmir. Kërkoj që ky objekt të përfshihet në planin lokal për ruajtje të trashëgimisë kulturore. Ajo çka po du me shtu dhe kërku, 200 metra është shtëpia e veprimtarit të qështjes kombëtare, të burgosurit politik, ushtarit të UÇK-së, drejtorit të radios Kosova e lirë radion të cilën e udhëheqë edhe sot është fjale për Ahmet Qeriqin. Ai në atë vend shkon dhe viziton çdo ditë aty nuk ka infrastrukturë nuk ka drita, kisha pasur dëshirë që Komuna me i ndihmu atij vendi. Po ashtu në atë vend gjinden edhe varrezat e tona. Gjithashtu aty ishte një vend ku ishin të vendosura karburantet për UÇK.

Lulzim Rrustemi, kam dy çështje për t'i ngritë; e para është ndërtimi i shkollës "Adem Gllavica" në cilën fazë ka mbërri dhe e dyta; e kemi një pronë komunale në udhëkryqin Lipjan, Magurë, Shtime që është e parapame për kategorit e dalura nga lufta, një projekt i dedikum për ndërtesa për këto kategori, kisha dashtë me ditë në cilin stad janë këto procedura dhe deri ku kanë mbërri.

Albulena Kelmendi, sot do t'i ngris dy qështje e para është çështja që lidhet me fshatin Shalë. Këtij fshati i mungojnë kushtet elementare ajo qka më së shumti i shqetëson këta qytetarë është deponia e mbeturinave që nuk menagjohet dhe është bartur në fshatin Blinajë dhe çështja tjetër është çështja e ujësjellësit që është i dëmtuar shumë. Po ashtu në QMF atje mungojnë kushtet elementare, problemi tjetër rrugët e pa ndriçuara, trotualet po ashtu në rrugën "Banush Sedllari" mungon ndriçimi publik, po ashtu në shkollën fillore mungojnë kushtet elementare sanitare. Puna e psikologëve që janë të caktuara në 2-3 nëpër shkolla mungon, vizitohen pak ose nuk vizitohen fare.

Ukë Kryeziu, unë sot dola për një sqarim ndaj qytetarëve si asambleist pasi që kohëve të fundit ka pasur disa shkrime rreth emrit dhe pozitës time si asambleist dhe anëtarë i KPF-së, duhet ta jap një spjegim. Unë kam qenë anëtarë i AAK-së në nëntor kemi bër njoftimin. Kryetari me një grup të madh të anëtarve të kryesisë ka pushuar aktivitetin e AAK-së. Kordinatori i AAK-së është dashtë së paku me kolegët paraprakisht me u konsultu me kolegët këtu që janë në Kuvend këtë qështje me sjell në kuvend e jo me bo deklarata mediatike se gjëja se Ukë Kryeziu po keqperdor pozitën e anëtarit të KPF-së. Edhe në kuvend e kam bër njoftimin ku kryesuesi mu ka drejtua me kërkesë të deklarohem se cilit subjekt i takoj. Në mbledhjen e 16-të të Kuvendit se është deklarimi im se unë Ukë Kryeziu i takoj grupit të PDK-së. Se a kam dhënë nga anëtar i KPF-së, e kanë të drejtën organet të veprojnë në bazë të Ligjit dhe Rregullores. Por në praktikën e kaluar anëtarët e Komiteteve që kanë kaluar në parti tjera nuk e kanë bërë edhe unë do t'i përmbahem këtij principi si në praktikën e kaluar.

Ramiz Qeriqi, kam për t'i ngritur disa shqetësime të qytetarëve po ashtu kam një ankesë të peshkatarëve që kur është punuar në lumin "Sitnica" nuk ka pasur kujdes për gjallesat e sidomos për peshqit. Është dashtë që këta peshqi me i dërgu në akuarium. Po të kishte me ndodh në një shtet të civilizum dikush është dashtë të përgjigjet dhe me shku në burg. Ne në disa prona si komision që i kemi dhënë në shfrytëzim kompanive ka prej atyre që kanë probleme me kojshi Foto "Hava" e ka paguar qiranë sipas marrëveshjes mirëpo ka pengesa nga fqinji që e ka afër me punua aty mbrapa, andaj

është mirë ta lirojmë nga pagesa. Emërtimi i shkollave a bëhet nga ne apo Ministria pasi që unë e pashë një vendim ku Ministria e ka emëruar shkollën në Shalë. Sa i përket diskutimit të Ganimetes për radio Kosova e lirë vetëm ta njoftoj se radio Kosova e lirë nuk ka qenë në Krojmir por ka qenë në malet e Berishës.

Ganimete Qeriqi, unë mbajë përgjegjësi morale dhe penale nëse gënjej diçka. Po kam kërkuar infrastrukturë për atë rrugë që nuk është shumë 200€ për atë njeri që shkon çdo ditë. Më kujtohet Kryetari në mbledhjen e kaluar kur tha se ne bëjmë rrugë për njerzët që punojnë dhe i qojmë rrugën deri te puna dhe ai njeri ka pemë, kopsht dhe çdo ditë shkon e punon.

Bashkim Budakova, kam një pyetje për drejtorin DKA-së në shkollën e minoritetit serb në fshatin Rubovc sa është duke menagjuar DKA-ja dha a është në dijeni se dy persona janë të punësuar dy persona serb në këtë shkollë dhe a paguhen nga buxheti i Kosovës.

Shkelzen Bislimi, kisha kërkuar Kryesues t'i kemi së paku nga dy pyetje e jo të lëshohemi në konkluzione e në polemika.

Argjend Tasholli, do t'i ngris disa çështje e kemi problemin e lumit që kalon rreth rrugës në fshatin Gadime gjatë pastrimit janë hedhur mbeturina në dy anët e lumit. Kërkesë e qytetarëve është që të bëhet pastrimi i asaj pjese. E kemi edhe një kërkesë të qytetarëve të Gadimes, Gllavicës dhe Marevcit kërkoj fusha për aktivitetet sportive.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se institucionet dhe komunat nuk munden me u kthyer në drejtim të individuale por nga e tërësishmja por të përgjithshmes jo të individuale, nuk mendoj se politikat lokale duhet kthyer kah individët do të ishte mirë por çdo individ është e pa mundur me ju kriju kushte për vizita turistike për ish vendin e vetë. Shkolla është e vërtetë që është nënshkruar me emrin e dëshmorit Shaqir Hoxha në Shalë nga Ministri por asnjë shkollë nuk mund të vendos emër pa shkresë të Kryetarit të Komunës. Propozimi ka ardhur nga shkolla dhe familja e ka aporovuar Kryetari i Komunës dhe i kam dërguar shkresë për elaborat Ministrit dhe Ministri pas dy dite e ka aprovuar. Shkolla e mesme "Adem Gllavica" nuk është duke shkuar me dinamikën që është parapa është e kontraktuar nga Ministria e arsimit këtë vit i ka vetëm 300 mijë euro në disponim nga Ministria kam kërkuar dinamikë më të shpejtë kanë premtu nga Ministria por nuk pres që në këtë vit me u përfunduar projekti i shkollës "Adem Gllavica". Pres me u renovuar objekti i tërësishëm i gjimnazit është një projekt i kontraktuar nga Amerikanët punimet priten me fillu kah fundi i muajit maj në ish objektin e vjetër të gjimnazit do të ketë një renovim të tërësishëm. Prona për invalid dhe veteran përballë tregut të kafshëve, një komision i përbërë prej Ministrave të caktuar që jep leje për partneritet publiko privat ka vite që e kemi dërguar por pa përgjigje ne duhet prap me riprocedu projektin me shiku deri ku ka shku. Çështjen e ambulancës ndoshta mund të thotë drejtoresha diçka. Deponia, uji dhe mbeturinat në Shalë. Ne duhet të gjejmë një gjuhë të përbashkët me komunitetin atje sepse njerëzit që kanë marrë përsipër me administruar, menagju interesin publik në ato lokalitete që me zgjidh problemin e ujit sepse nuk kanë leju me hy në sistem dhe nuk kanë leju me marrë kompania. Atje kemi probleme edhe me burimet e ujit aty ku kanë marrë nuk lejohet me bërë shpime të reja. E njëjta çështje e mbeturinave ata insistojnë vet me i menagju mbeturinat përmes një kompanie private. Ne kemi kërkuar edhe në Shalë me hy në raporte kontraktuale me ndërmarrjen komunale "Pastrimi" e pastaj me marrë përgjegjësinë ndërmarrja. Jemi në procedurë brenda këtij viti për t'i blerë 8 mijë shporta tjera për të paisur çdo familje. Ne në Lipjan nuk e kemi aprovuar udhëzimin administrativ deri se nuk u kemi plotësuar kushtet. Së pari do të fillojmë me lokalet e bizneseve sepse nuk mund të ketë lokal e të mos ketë shport të mbeturinave. Çështja e psikologëve që e përmendi Albulena ndoshta mundet drejtori të na jap s'çarime. Ne duhet ta bëjmë një mbikëqyrje nëse nuk janë në

nivelin e duhur. Çështja e fushave të hapura 5 fusha janë të projektuara për momentin, nuk do të ketë fshat që nuk do të ketë fushë. Çështja e mbeturinave rreth shtratit të lumit në Gadime nuk e di që ka mbetje të tilla, duhet me shku inspektorët me shiku. Sa i përket çështjes së Ukës nuk kam çka të them merruni ju vesh në Kuvend.

Bashkim Budakova, Kryesues unë edhe në seancën e kaluar edhe sot kam bërë një pyetje por nuk mora përgjigje.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, në sistemin e pagesave që është publik nuk kemi asnjë punëtorë serb.

Ramiz Qeriqi, e kam pa një vendim të Ministrit për ata dhe thash që ka qenë vendim i Ministrit. Deshta të jap një kontribut për veprimtarët e çështjes kombëtare është mirë të sillen me shkrim çështjet. Deshta të jap një sçarim pasi që jam pjesë e asaj historie.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 17-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari, së pari përshëndes kolegët e ri asamleistët. Sa i përket ekstraktit në formë të shkruar nuk kam vërejtje, por sa i përket materialin që është dërguar në mënyrë elektronike nuk ka qenë i renditur si duhet këtë po e them pasi unë përshtatshëm këtë material e arhivoj.

Meqë vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 17-te dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 votat për aprovoi këtë:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 17-të e Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2019

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, jemi në shqyrtim të shpenzimeve të buxhetit për 3 mujorin e parë një dokument të rëndësishëm në përputhje me ligjin që është obligative për shpenzim dhe alokim. Në bazë të kësaj çka po shihet është një shpenzim jashtëzakonisht i ulët. E kuptojmë që buxheti është aprovuar më von por shifrat tregojnë një menaxhim të ulët të shpenzimeve të buxhetit. Buxhetin në përgjithësi e kemi mbi 45% që është shpenzu shohim se ky shpenzim është bërë për rroga dhe paga. Te buxheti dhe të hyrat vetanake nuk kemi shpenzime fare. Te mallra dhe shërbime kemi 30% shpenzime ku 25% janë paga. Buxhetet dhe shpenzimet nga donacionet të të hyrat vetanake nuk kemi shpenzim fare. Shpenzimet publike te

Shërbimet Publike buxheti sipas fondeve dhe programeve, kategorive ekonomike, te granti qeveritar 10 mallra dhe sherbime 16%. Te zhvillimi në bujqësi vetëm 1.75%. Te investimet kapitale të hyrat vetanake zero shpenzime. Te DKRS, shumë pak. Arsimi para fillor zero shpenzime. Te arsimi i mesëm ska paraqitje te investimeve. Shpenzimet për telefona mobil, vetura dhe mirëmbajtje të veturave, karburante është një shpenzim i tejkaluar. Ne si grup parlamentar për këtë raport mendojmë se është një menaxhim i dobët për këtë periudhë 3 mujore.

Albulena Kelmendi, unë nuk dua t'i përsëris atë çka kam menduar e tha parafolësi ajo çka vërehet në këtë raport 3 mujor të shpenzimeve është një menagjim i dobët por brenga e jonë është dikun zero, dikun shpenzimet e ulëta, ndërsa shpenzimet për telefoni mobile, vetura, karburante, mirëmbajtjet janë tepër të mëdha.

Ramiz Qeriqi, unë kam vërejtur te tregjet pagesa vlera 13 mijë euro nuk ka sçarim, këtu nuk ka sa pika shiten në treg sipas javëve. Në treg të gjelbërt dhe të kafshëve nuk tregon për tregun e veturave të shtuneve. Janë disa dreka dhe darka 20€ nuk e dijë se çka janë këto dreka-darka. Shërbime kontraktuese nuk shkruhet kush janë kontraktorët janë gjëra të pa sqarume.

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentar i LDK-se e kemi shqyrtu raportin. Ne gjithmonë kemi pengesa me shpenzu buxhetin për shkak të bartjes së fakturave nga viti i kaluar në këtë vit. Ne shpresojmë se do të kemi një shpenzim më të lartë të këtij buxheti në muajt në vazhdim. Arsya ka qenë aprovimi i vonuar i buxhetit siqë e tha edhe drejtori të shpenzohet buxheti për investimet kapitale. Po ashtu në këtë vit kemi rritje të hyrave 12% më të larta në krahasim me periudhën e njëjtë kohore të vitit të kaluar.

Latif Ramadani, buxheti është aprovuar në muajin mars dhe ne e kemi aprovuar me kohë dhe nuk është faji ynë. Ky buxhet i aprovuar në Kuvendin komunal duhet me u aprovua edhe në Kuvendin e Kosovës e tek atëherë bëhet Ligj. Qeveria me vendim kur nuk aprovohet buxheti në nivel qendror e alokon 1/12 e buxhetit sipas vitit 2018. Ashtu qysh ka qenë në janar të vitit 2018 ashtu edhe në janar 2019 dhe nuk ka asnjë keq menagjim. Sa i përket pyetjes së Lulit për fakturat ato janë fakturat e muajit nëntor të vitit të kaluar, për shkak të vitit fiskal ato faktura barten në këtë vit. Te Çerdhja, Lul, të gjitha mjetet janë. Sa i përket pyetjes së Luanit për fakturat 20€ për dreka dhe darka për drejtorët janë shpenzimet e reprezentacionit që çdo drejtor i ka nga 20€. Në të kaluarën kanë qenë 50€, ndërsa tash i kanë nga 20€ dhe ka një ulje edhe kështu do të jetë. Shërbimet kontraktuese janë kompania e "Pastrimit", sigurimi i komunës, mirëmbajtja e tregjeve, mirëmbajtja e parqeve dhe rrugëve. Unë thash se është një shpenzim i ulët por zakonisht shpenzimet e ulëta ndodhin në 3 mujorin e parë. Këtë vit Qeveria e ka aprovua në muajin mars. Ndërsa të hyrat vetanake nuk kanë mundur me u shpenzu në mbledhjen e kaluar e kemi aprovu bartjen e të hyrave dhe prej prillit fillon shpenzimi ashtu qysh e kemi planifiku.

Ramiz Qeriqi, pyeti se a ju raporton kjo kompania e tregjeve sa pika i ka shitje në dy tregjet.

Albulena Kelmendi, ne jemi duke bërë vlerësimin e një raporti në bazë të asaj se çka po shohim dhe në bazë të asaj që po shohim ky raport i shpenzimeve është i ulët dhe ashtu do ta vlerësojmë.

Latif Ramadani, për pyetjen tuaj Luan është menaxheri që e mbikëqyr dhe neva na i sjellë raport e të hyrave dhe ne raportojmë në bazë të hyrave që i kemi për tregje. Ne Albulenë raportojmë ato shpenzime që janë reale dhe asgjë më tepër dhe ky është informimi më i mirë i publikut.

Lulzim Rrustemi, ne e kemi një raport të shkruar dhe të saktë dhe në bazë të saj çka shohim ngritim shqetësimet tona për bujqësi, kulturë ,rini, urbanizëm dhe në bazë të këtij raporti ne shohim se ka shpenzime jashtëzakonisht të ulëta. Dhe në karburante, mirëmbajtje të veturave, janë tepër të mëdha. Neve nuk na shkruan cilat faktura janë të bartura.

Latif Ramadani, punët dhe projektet në teren janë duke u kryer sipas dinamikës së paraparë por pa u pranuar teknikisht nuk llogaritet. Dhe ne nëse nuk mundemi t'i paraqesim në këtë raport do t'i paraqesim në raportin e ardhshëm.

Ilir Tasholli, lidhur me realizimin e projekteve mund të themë se ka një dinamikë që nuk është parë asnjëherë më parë. Mbi 80% të projekteve kemi hy në procedurat të prokurimit edhe për shpenzimet e buxhetit. Jemi ndër komunat e para në shpenzimet e buxhetit. Kemi probleme edhe për projektet e financuara nga niveli qeveritar. Asfaltimi i rrugës udhëkryqi i Janjevës deri në Lipjan ku çdo vit e qesin buxhetin dhe çdo vit e heqin buxhetin për këtë rrugë.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike u kalua në punë sipas pikës së tretë të rendit të ditës.

III

Propozim Rregullore për transportin e udhëtarëve me automjete Taksi

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Ilir Tashollit drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Majlinda Sylejmani, na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Rregullore për transportin e udhëtarëve me automjete taksi. Me qenë se kjo Rregullore ka për qëllim vazhdimin e licencave dhe të krijoj kushte rreth kësaj veprimtarie të këtyre personave që merren me taksi.

Ramiz Qeriqi, unë kam një kërkesë aty ku thuhet te ndalesat u ndalohet me i pranu gjatë udhëtimit më shumë se 4 udhëtarë. Unë kërkoj këtyre taksive furgona që operojnë në Lipjan për t'i mundësuar me i marrë nga 6 udhëtar. Dhe po më intereson pse ua keni ndaluar atyre automjeteve taksi që janë me gas?

Albulena Kelmendi, ajo çka e kam ngritë si qështje edhe në KPF ka qenë puna e çmimeve ku në shumicën e rasteve taksit që vozisin nëpër fshatra i ndryshojnë çmimet të premtën, të shtuneve dhe të dieleve, andaj unë kam një kërkesë që puna e çmimeve të rregullohet.

Afrim Miftari, ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë propozim Rregullore. Kjo Rregullore është e mirë e punuar nga licencimi dhe kushtet deri te zbatimi. Nuk është përfundimtare të ardhmen mund edhe të modifikohet andaj ne e përkrahim këtë propozim Rregullore.

Ukë Kryeziu, tha se ne e kemi shqyrtuar këtë propozim Rregullore është e mirë, kërkojmë nga inspektoriat i punës që pastërtia e auto taksive të jetë në nivel të duhur.

Lulzim Rrustemi, është një Rregullore e mirë pasi që i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara me Ligj. Por unë i kam dy propozime për ndryshim të propozim Rregullores te neni 5. Aty ku shkruhet drejtuesit e automjeteve të kategorisë B të ketë së paku 5 vite përvojë pune kjo mund të jetë pengesë për shoferët e rinjë mendoj që 3 vite janë të mjeftueshme nëse nuk është e paraparë ndryshe me Ligj. Te neni 1.7 ku parashihet që automjeteve taksi që veprojnë në komunën e Lipjanit të jetë 2000, ndërsa për aeroport 2003 mendoj që nuk është

lehtësime për ata që i mbajnë familjet e tyre. Po ashtu kisha kërku që edhe ngjyra mos të ndërrohet pasi që kjo është një kosto e madhe.

Ilir Tasholli, në pyetjen e Ramizit për më tepër se 4 udhëtarë sipas udhëzimit administrativ dhe Ligjit për transport nuk lejohet të ket më tepër se 4 udhëtarë. Pse janë të ndaluara automjetet me gas arsyeja është se janë të ndaluara me Ligj sepse paraqesin rrezik për udhëtarët. Vetëm ato automjete që janë të çertifikuara dhe fabrikisht mund të përdorën e jo ato që janë të modifikuara më vonë.

Albulena ka pyetur edhe në mbledhjen e kaluar për çmimet, si rregullohen çmimet? Sipas çmimeve të tregut. Komuna nuk ka të drejtë me ndërhy në çmime. Ne kemi bërë kërkesë te Ministria kompetente për interpretim ligjor për këtë çështje por nuk na është kthyer përgjigjja. Në pyetjen e Ukës lidhur me pastërtin dhe higjenën ne në bashkëpunim me inspektoriatin dhe policinë do të mundohemi me i implementu Rregulloren. Sa i përket gjinisë femërore ne i inkurajojmë gjithsesi gjinin femërore me apliku. Në kushte të barabarta do të kenë përparësi gjinia femërore. Luli 5 vite përvojë pune për një operator që ka në dorë jetën e të tjerëve është minimum që është e parapame. Kurse në lidhje me vitin e prodhimit dhe ngjyrën kemi pasur debate edhe takime me shoqata dhe me taksist individual që viti i prodhimit të gjendet një konsensus. Me pajtimin e shumicës që kemi debatuar gati një muaj kemi ardhur në përfundim edhe për ngjyrën edhe për vitin e prodhimit. Kërkesë e shoqatave dhe e auto taksive ka qenë minimumi të jetë viti i prodhimit 2003 për aeroport.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, 1 abstenim, aprovoi këtë:

RREGULLORE PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i miratimit të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna në pajtim me Ligjin Nr.04/L-179 për Transportin rrugor të krijoj kushte për ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe të rregullojë mënyrën e kryerjes së veprimtarisë të personave fizik dhe juridik të regjistruar për transportin e udhëtarëve me automjete taksi.

Neni 2 Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohet objekti i rregullimit, si vijon:

Subjektet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me automjete taksi, Licenca dhe kushtet për lëshimin e Licencës, procedura e lëshimit, revokimit dhe e marrjes së të Licencës, caktimi dhe dhënia në shfrytëzim e vendparkingjeve, ushtrimi i veprimtarisë, evidencat, detyrat për zbatimin e rregullores, masat për mosrrespektimin e rregullores,

procedura e ankesave, dispozitat përfundimtare dhe dispozitat për hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 3

Subjektet për ushtrimin e veprimtarisë

Në pajtim me Ligjin për Transportin rrugor dhe me këtë Rregullore, të drejtë për bartjen e udhëtarëve me automjete taksi në territorin e Komunës së Lipjanit kanë personat fizik dhe juridik të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë të transportit të udhëtarëve me automjete taksi (në vazhdim të tekstit: Operatorët), të cilët posedojnë Licencën dhe automjetet me të drejtë të shfrytëzimit të vendparkingut të caktuar për automjete taksi.

II. LICENCA DHE KUSHTET PËR LËSHIMIN E LICENCËS

Neni 4

Licenca

1. Licenca është akt me të cilin i lejohe operatorit ushtrimi i veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me automjete taksi në territorin e Komunës së Lipjanit sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për Transportin rrugor dhe me këtë Rregullore.
2. Formën dhe përmbajtjen e Licencës në pajtim me Ligjin dhe me këtë Rregullore e përcakton Drejtorati i shërbimeve publike.
3. Licenca i lëshohet operatorit – personit fizik për ushtrimin e veprimtarisë të transportit me 1 (një) automjet taksi, ndërsa personit juridik për ushtrimin e veprimtarisë prej tri e më shumë automjeteve.
4. Licenca lëshohet në emër të operatorit dhe në rast të pushimit të veprimtarisë ose revokimit nuk mund të zëvendësohet ose të bartet te personat e tretë.
5. Licencën e lëshon Drejtorati për Shërbime publike në kohëzgjatje prej 5 vite, ndërsa tek personat të cilët arrijnë moshën 65 vjeçare licenca i`ju lëshohet për aq kohë-vite deri në arritjen e moshës së pensionimit.
6. Për marrjen e Licencës operatorët duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara me nenin 5 dhe 12 të kësaj Rregulloreje.
7. Aplikimi për marrjen e licencës bëhet përmes njoftimit publik.
8. Me rastin e marrjes së licencës operatori fizik është i obliguar ta paguajë taksën prej 30 eurove, ndërsa personi juridik është i obliguar ta paguajë taksën prej 30 eurove për çdo veturë.
9. Operatori auto taksi i cili nuk i ka kryer obligimet ndaj Komunës për pagesën e vendqëndrimit në auto parking nuk ka të drejtë të aplikimit për t`u pajisur me licencë pa i kryer obligimet ndaj Komunës.

Neni 5

Kushtet për licencim

Operatorët për marrjen e Licencës duhet të plotësojnë kushtet në vijim:

- 1.1 Të jenë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë të transportit të udhëtarëve me automjete taksi,
- 1.2 Të kanë selinë e biznesit në territorin e Komunës së Lipjanit,
- 1.3 Personat fizik të kenë në pronësi automjetin, ndërsa personat juridik të kenë në pronësi së paku 3 automjete,
- 1.4 Automjeti duhet të jetë i regjistruar me 5 ulëse (4+1) dhe së paku 4 dyer (nuk pranohet homologimi ose ndryshimi i ulëseve të automjetit),
- 1.5 Ngjyra e automjetit të jetë e verdhë,
- 1.6 Drejtuesit e automjeteve të posedojnë patentë shoferin për kategorinë "B" dhe së paku 5 vite përvojë në drejtimin e automjetit, ndërsa të punësuarit te personi juridik edhe kontratën e punës,
- 1.7 Operatorët të cilët operojnë auto taksi në qytetin e Lipjanit duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se viti 2000 ndërsa operatorët të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se viti 2003.
- 1.8 Përparësi për t'u pajisur me licencë në kushte të barabarta do të kenë operatorët të cilët kanë ushtruar veprimtarinë taksi.
- 1.9 Automjetet të cilat e bëjnë djegijen me gas nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë auto taksi.

III. PROCEDURA E LËSHIMIT, REVOKIMIT DHE E MARRJES SË LICENCËS

Neni 6 Njoftimi publik

1. Kryetari i Komunës merr vendim për shpalljen e njoftimit publik për dhënien e licencave dhe formon Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve dhe verifikimin e automjeteve. Komisioni të jetë në përbërje prej 5 anëtarëve: tre zyrtarë komunal, një zyrtarë policor dhe një anëtarë të jetë një ekspert nga kontrolla teknike.
2. Njoftimi publik shpallet në faqen elektronike të Komunës dhe në një gazetë ditore.

Neni 7 Dokumentacioni për licencim

Operatorët të cilët aplikojnë për marrjen e licencës, aplikacionit duhet t'i bashkëngjesin dokumentacionin, si vijon:

- 1.1 Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit,
- 1.2 Informatat mbi të dhënat e biznesit,
- 1.3 Fotokopjen e Certifikatës së regjistrimit të automjetit,
- 1.4 Për drejtuesit e automjeteve fotokopjen e patent shoferit për kategorinë "B", ndërsa për të punësuarit edhe kopjen e kontratës së punës,
- 1.5 Vërtetimi nga Policia mbi të kaluarën kriminale të operatorit dhe vozitësit te personat juridik.

Neni 8 Shqyrtimi i aplikacioneve

Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve sipas njoftimit publik, në afat prej 20 dite nga dita e pranimi të vendimit për formimin e komisionit, shqyrton aplikacionet, verifikon automjetet dhe harton Raportin me listën e operatorëve të cilët i plotësojnë kushtet për dhënien e Licencës, të cilin ia dërgon Drejtoratit për shërbime publike.

Neni 9 Revokimi dhe marrja e Licencës

1. Për revokim, ndërprerje të afatit dhe marrje të licencës vendos Drejtorati për shërbime publike.

2. Licenca do të revokohet nëse vërtetohet se Operatori për marrjen e licencës ka prezentuar dokumentacion i cili nuk përkon me gjendjen reale.

3. Licenca do të pushojë të vlejë, në rastet në vijim:

3.1 Me kërkesë me shkrim të operatorit,

3.2 Me rastin e vdekjes së personit fizik ose shuarjes së veprimtarisë së personit juridik,

3.3 Kur Drejtorati, vërteton se operatori gjatë ushtrimit të veprimtarisë më nuk i plotëson kushtet nga nenet 5 dhe 12 të kësaj rregulloreje.

4. Drejtorati i Inspektoratit – Inspektorët e trafikut, konform këtij neni, gjatë mbikëqyrjes inspektive do të njoftojnë Drejtoratin për shërbime publike dhe do t'i prezantojnë provat për rastet për të cilat duhet të fillohet procedura për revokim dhe marrje të licencës.

IV. CAKTIMI DHE DHËNIA NË SHFRYTËZIM E VENDPARKINGJEVE

Neni 10 Vendparkingjet

1. Për kryerjen e veprimtarisë të bartjes së udhëtarëve me automjete taksi, Komuna siguron dhe mirëmbanë Vendparkingjet për qëndrimin e automjeteve taksi për marrjen e udhëtarëve për personat fizik, ndërsa për personat juridik vendqëndrimi për automjetet taksi nuk sigurohet nga Komuna por nga vetë personat juridik.

2. Kryetari i Komunës, në propozim të Drejtoratit për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit dhe Drejtoratit të shërbimeve publike, me Vendim përcakton lokacionet për vendparkingje dhe numrin e automjeteve që mund të vendosen në vendparkingje.

3. Në hyrje të vendparkingut duhet të vendoset shenja vertikale me mbishkrim "TAXI".

Neni 11 Caktimi i vendparkingjeve

1. Vendet për qëndrimin e automjeteve për marrjen e udhëtarëve në vendparkingun e caktuar për automjete taksi, do t'u jepen në shfrytëzim operatorëve të licencuar për këtë vendparking.

2. Automjetet taksi, renditen në vendparking sipas kohës së arritjes.

3. Operatorët e licencuar për automjete taksi, për shfrytëzimin e autoparkingjeve duhet të paguajnë taksën vjetore sipas Rregullores për Taksat Komunale.

4. Operatorët të cilët nuk i kryejnë obligimet e pagesës për vendqëndrim në vendparkingje brenda afatit prej tre muajve duke filluar nga data 01.01 deri më 31.03 të vitit përkatës Komuna do të bëjë ekzekutimin përmes procedurave përmbarimore.

V. USHTRIMI I VEPRIMTARISË

Neni 12

Kushtet për automjetet taksi

1. Për t'u pajisur me licencë operatorët taksi përveq dokumentacionit të dorëzuar për licencim duhet ti plotësojnë këto kushte:

1.1 Operatorët të cilët operojnë në qytetin e Lipjanit të kenë të ngjyrosur automjetin me ngjyrë të verdhë, ndërsa operatorët të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashri" kenë të ngjyrosur automjetin me ngjyrë të bardhë, të regjistruar, teknikisht në gjendje të rregulltë si dhe pa dëmtime në pjesën e jashtme dhe të brendëshme të automjetit,

1.2 të posedojë taksimetrit e vendosur në automjet në gjendje të rregulltë, i bazhdaruar nga organi kompetent,

1.3 të ketë të vendosur mbi kabinë paralel me erëmbrojtësin tabelën me dimensione standarde e paisur për ndriqim natën me shenjën "TAXI",

1.4 të posedojë aparatit për fikjen e zjarrit,

1.5 të posedojë sistemin e ngrohjes dhe të ventilimit.

2. Në automjet, drejtuesi i automjetit, përveq Certifikatës mbi regjistrimin e automjetit dhe patent shoferit, duhet të posedojë :

3.1 Kopjen e Licencës,

3.2 Çmimoren e shërbimeve.

Neni 13

Transporti i udhëtarëve

1. Transporti i udhëtarëve në automjetet taksi bëhet: nga vendparkingjet e destinuara për automjete taksi, sipas thirrjeve të udhëtarëve me mjete të komunikimit (me telefon) nga vendi i caktuar nga udhëtari dhe kur automjeti është në lëvizje, me kërkesë të udhëtarit për t'u ndalur, në vendin e lejuar në të cilin nuk rrezikohet komunikacioni.

2. Drejtuesi i automjetit në autoparking duhet të qëndrojë në automjet për marrjen e udhëtarëve.

3. Operatori nuk ka të drejtë të qëndrojë për marrje të udhëtarëve në vendndaljet e destinuara për autobus.

Neni 14

Çmimorja e shërbimeve

1. Operatorët duhet të përcaktojnë Çmimoren e shërbimeve.

2. Çmimorja vendoset në automjet afër taksimetrit në vend të përshtatshëm për t'u lexuar nga udhëtari.

3. Operatori për shërbimet e transportit i jep udhëtarit dëshminë mbi kryerjen e pagesës.

Neni 15

Ndalesat gjatë ushtrimit të veprimtarisë

1. Gjatë transportit të udhëtarëve me automjete taksi nuk është e lejuar:

1.1 Vendosja dhe qëndrimi i automjeteve për pranimin e udhëtarëve jashtë vendparkingjeve për automjete taksi për personat fizik,

1.2 Kryerja e transportit të udhëtarëve pa Licencë dhe pa vend të përcaktuar për qëndrim të automjetit në vendparkingjet për automjete taksi,

1.3 Zbritja e udhëtarëve në vendndaljet e autobusëve,

1.4 Bartja e udhëtarëve - fëmijëve nën moshën 6 vjeqare pa përcjellës,

1.5 Bartja e udhëtarëve nën ndikim të alkoolit dhe të narkotikëve,

1.6 Vendosja në automjet e relacionit dhe emërimit të vendit të udhëtimit,

1.7 Vendosja e reklamave në automjet,

1.8 Hijezimi i dritareve të automjetit,

1.9 Pranimi i më tepër se 4 udhëtarëve,

1.10 Bartja udhëtarëve pa tabelën taksi,

1.11 Marrja e udhëtarëve jashtë territorit të Komunës,

1.12 Bartja e mallrave, kafshëve dhe shpezëve ,

1.13 Pirja e duhanit në automjet dhe

1.14 Përdorimi i mjeteve audiovizuele me zë të lartë.

VI. EVIDENCAT

Neni 16

Regjistri i licencave

1. Drejtorati për shërbime publike në formë fizike dhe elektronike mbanë Regjistrin e Licencave të operatorëve për ushtrimin e veprimtarisë me automjete taksi.

2. Regjistri i licencave përmbanë:

2.1 Numrin e licencës,

2.2 Datën e licencës,

2.3 Emërtimin e operatorit,

2.4 Kohëzgjatjen e licencës.

VII. DETYRAT PËR ZBATIMIN E RREGULLORES

Neni 17

Obligimet e organeve të Komunës

1. Drejtorati i shërbimeve publike dhe organet tjera të administratës së Komunës në kuadër të kompetencave, në pajtim me ligjin dhe me këtë rregullore kanë obligim për ndërmarrjen e masave dhe nxjerrjen e akteve për zbatimin e kësaj rregulloreje.

2. Drejtorati i Inspektoratit – Inspektorët e trafikut duhet të informojnë me shkrim Drejtoratin e shërbimeve publike mbi masat e ndërmarra të mbikëqyrjes inspektive për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 18
Obligimet e operatorëve

Operatorët, transportin e udhëtarëve me automjete taksi duhet ta kryejnë në pajtim me Ligjin për Transportin rrugor dhe me këtë Rregullore.

VIII. MASAT PËR MOSRRESPEKTIMIN E RREGULLORES

Neni 19
Fletëparaqitja për kundëravajtje

Inspektorët komunal të trafikut, përveq masave të parapara me dispozitat e Ligjit për Transportin rrugor, ushtrojnë fletëparaqitje për kundëravajtje ndaj operatorëve dhe personave të cilët, në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve me automjete taksi.

IX. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 20
Kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa

1. Pala e pakënaqur me Vendimet e bazuara në këtë Rregullore të Drejtoratit për Shërbime publike dhe të Inspektorit të trafikut mund të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim të Vendimit ose Ankesë komisionit komunal për ankesa të formuar me Vendim të kryetarit të komunës.

2. Kundër vendimit të komisionit komunal të ankesave të përcaktuar sipas paragrafit. paraprak të këtij neni pala mund të parashtrojë Ankesë e cila i dërgohet Ministrisë të Infrastrukturës - Departamentit të Transportit, në afat prej 30 dite nga dita e njoftimit të Vendimit.

X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 21
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 1Nr.011-27942 e datës 21.07.2014, Rregullorja 15Nr.011-45598 e datës 12.11.2014 për ndryshimet dhe plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-27942 e datës 21.07.2014 dhe Rregullorja 15Nr.011-22914 e datës 03.05.2016 për plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-27942 të datës 21.07.2014.

Shtesë: Rregullorja .

IV

Propozim Vendim për shfuqizimin e pjesërishëm të vendimit 15Nr.464-40375 të dt. 29.09.2014 dhe shfuqizimin e tërësishëm të vendimit 15Nr.464-61538 dt. 21.12.2015.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Shkelzen Hajdini, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi, mua po më intereson pse kjo kontratë nuk është ndërpre para një viti duke ditur se kjo kompani e ka pasur një marrëveshje të nënshkruar me komunën. Ka pasur për 3 muaj me u pajisë me leje ndërtimi. Në afat prej 2 viteve është dashtë me funksionu fabrika dhe me i pasur të punësuar mbi 50% të punëtorëve. Dhe është dashtë së paku para 2 vite me ja ndërpre kontratën kur e keni pa se nuk ju ka përmbajtur kriterëve.

Afrim Miftari, përveq këtij vendimi për shfuqizimin e pjesërishëm të këtyre vendimeve paraprake e kemi edhe një kontratë të nënshkruar në vitin 2016 prej dy palëve në këtë kontratë precizohet në nenin 7 cilat janë mënyrat e shkëputjes e kësaj kontrate. Ne si grup parlamentar mendojmë se janë shterrur të gjitha mundësitë ku është dalë edhe në vendin e ngjarjes dhe është parë se nuk punohet na jemi për shkëputjen e këtyre dy vendimeve paraprake dhe inkurajojmë që edhe rastet tjera të hulumtohen dhe atyre që ju ipen kontrata të tilla të ju përmbahen nënshkrimeve të veta dhe ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim.

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentar i LDK-së duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës së Lipjanit dhe Ligjin e ri për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronave komunale si dhe kushteve të parapara në kontratë e përkrahim propozim vendimin për shkëputjen, shfuqizimin e pjesërishëm, si dhe shfuqizimin e tërësishëm të vendimit të vitit 2015. Inkurajojmë që edhe më tutje të veprohet edhe me prona tjera komunale.

Lulzim Rustemi, është një vendim i mirë por pak i vonuar. Është dashtë me kohë pasi kemi nenet që përcaktojnë për dhënien e lejes së ndërtimit dhe kur shihet se operatorët nuk marrin leje, nuk ka nevojë me prit janë fazat të cilat duhet të kalohen. Është mirë që operatorët që nuk ju përmbahen afateve kohore nuk duhet të pritët me vite por menjëherë duhet të veprohet. Ne e përkrahim këtë propozim vendim por me kërkesën që edhe vendime tjera të rishikohen.

Shkelzen Hajdini, ne kemi bërë një avansim të theksuar dhe po e marrim një pronë që e kemi dhënë në vitin 2016. Dhe procedurat për dhënien e pronës po marrin kohë po ashtu edhe marrja e pronës procedurat po na marrin kohë. Ne jemi kah angazhohemi për t'i kthyer pronat komunale të cilat i kemi dhënë në shfrytëzim. U tha se nuk po punohet për zhvillimin ekonomik dhe nuk ka interes. Komuna është duke punuar shumë rreth krijimit të zhvillimit ekonomik.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E PJESËRISHËM TË VENDIMIT 15NR.464-40375 TË DT.29.09.2014 DHE SHFUQIZIMIN E TËRËSISHËM TË VENDIMIT 15NR.464-61538 DT.21.12.2015

I. SHFUQIZOHET pjesërisht vendimi paraprak 15Nr.464-40375 të dt.29.09.2014 i Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim aftgjatë të pronave të paluajtshme të komunës të parcelave kadastrale P-71409059-559-4 dhe P-71409059-552-2 me sipërfaqe prej 2.00,00 ha në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve.

II. SHFUQIZOHET në tërësi vendimi i Kuvendit të Komunës 15Nr.464-61538 dt.21.12.2015 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të parcelave kadastrale P-71409059-559-4 dhe

P-71409059-552-2 me sipërfaqe prej 2.00,00 ha në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve.

III. AUTORIZOHET Kryetari i Komunës që në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, të marr Vendim për shkëputjen e kontratës 1Nr.464-9266 dt.25.02.2016 për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës me shfrytëzues Hevzi Azizi nga fshati Sllatinë e Epërme-Ferizaj ,Betoni-MB, SH.P.K, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të kontratës dhe me të njejtin të njoftojë Kuvendin e Komunës.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastrë, Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Drejtorati për Inspektion.

V. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për të pame në fshatin Ribar i Madh.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Sefer Tashollit, drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendim.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nehat Tërpeza, përshëndes dy asambleist e ri dhe ju uroj punë të mbarë. Ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe e përkrahim kërkesën e qytetarëve të Ribarit të Madh për ndërtimin e një objekti për të pame.

Lulzim Rustemi, tha se kam dy pyetje a kemi dakordim prej qytetarëve dhe tjetra si qëndron plani zhvillimor urbanistik komunal. Nëse kemi sqarim në këto dy pyetje atëherë ne jemi për këtë propozim vendim.

Arben Salihu, nuk e dijë pse kërkesa po duhet me ardhur nga BI, kur dihet që kjo kërkesë po bëhet nga qytetarët. Kjo nuk po i ndahet BI, por po ndahet për qytetarët.

Ramiz Qeriqi, edhe unë e përkrahu Arbenin dhe është mirë që për këto raste kërkesat të vijnë në emër të qytetarëve.

Sefer Tasholli, kërkesa e qytetarëve është unike dhe nuk besoj që paraqesin problem rreth kësaj çështje. Unë sot jam takuar edhe me familjen Grajçevci që është më së afërmi dhe janë pajtuar. Po bëhen kërkesat në emër të BI, për arsye se kur të ipet në shfrytëzim duhet të regjistrohet në emër të dikujt dhe këto po bëhen në emër të BI.

Nehat Tërpeza, sa i përket çështjes së ngritur unë e kam diskutuar me shumicën e banorëve dhe aty nuk ka asnjë zë kundër këtij objekti.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR TË PAME NË FSHATIN RIBAR I MADH

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet lokacioni për ndërtimin ndërtimin e objektit për të pame (për raste të vdekjeve) për nevojat e banorëve të fshatit Ribar i Madh me sipërfaqe prej 500m² (5ari) nga pjesa e parcelës kadastrale P-71409014-00961-0 në vendin e quajtur "Selo" me kulturë kullosë e klasës së 2-të me sipërfaqe të përgjithshme prej 7470 m² Zona Kadastrale Ribar i Madh, P.Sh.Komuna Lipjan.

Neni 2

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të bënë parcelimin e sipërfaqës prej 500 m² të dedikuar për objekt për të pame (për raste të vdekjeve) në përputhje me planin zhvillimor komunal dhe njësisë së re kadastrale të krijuar dhe pas parcelimit ta evidenton në librat kadastral si pronë e kuvendit komunal.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendim për dhënien e pelqimit për ndarjen e mjeteve financiare shoqatës sindikale të administratës komunale, Nr. 1-400-26014 i datës 15. 04. 2019.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Olluri, drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendim.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, në vitin e kaluar e kemi pasur një kërkesë të tillë. Ne si grup do ta përkrahim çdo kërkesë që do të na vije nga sindikata për trajnime profesionale, ndërsa sa i përket vizitës së punëtorëve të administratës në Shqipëri jemi kundër, pasi që këto mjete ka mundur të shkojnë diku tjetër ku ka nevoja më të mëdha.

Arben Salihu, kisha pasur dëshirë që sindikata të na bie një raport në Kuvend për shpenzimet nga viti i kaluar.

Afrim Miftari, është e drejtë e punëtorëve të sindikatës që të kalojnë pushimin dikun së bashku pasi që edhe vet participojnë përmes anëtarësisë në sindikatë dhe këta po shkojnë në vikend e nuk po shkojnë ditëve të punës. Ne e përkrahim dhe jemi për.

Ganimete Qeriqi, unë e përkrahu këtë propozim vendim.

Lulzim Rrustemi, është mirë që sindikata me ju përmbajt atij projekti me realizu edhe takime zyrtare të cilat janë në projekt, është mirë që na me pasur edhe një raport për vizitat që i ka pasur.

Ramiz Qeriqi, unë e kam një kërkesë që në vitin e ardhshëm të mos jetë data 3-5 maj pasi që është dita e dëshmorëve, po ashtu e kam ditën e kazermës.

Avni Olluri, sindikata ka parapa që të ketë edhe disa takime zyrtare, sa i përket raportit sindikata na ka njoftuar që nga viti i kaluar ju kanë tepruar 1mijë euro. Ne mund të kërkojmë një raport vetëm për pjesën tonë.

Nehat Tërpeza, sindikatat janë organizata të pavarura dhe nuk mundem të kërkojna raport prej tyre por mund të kërkojmë vetëm për mjetet e ndara.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 25 votat për, 2 kundër aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE SHOQATËS SINDIKALE TE ADMINISTRATËS KOMUNALE

Neni 1

I ipet pëlqimi Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare, në shumë prej 5000 €, (pesë mijë) euro, sipas Kërkesës së Shoqatës Sindikale të pavarur e

Administratës Komunale të datës 12.04.2019, me qëllim të mbështetjes financiare të 210 (dyqind e dhjetë) të punësuarve të Administratës Komunale për realizimin e vizitës dy ditore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2019.

Neni 3

Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 12,³⁰

Ekstraktin e hartoi
Rrahim Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi